Republika e Kosovës
Qeveria
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Procedurat për shqyrtimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis

Legjislacioni për VNM

- Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L- 214, është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 23 Shtator 2010.
- **Udhëzimi Administrativ Nr.08/2015** Për Përcaktimin e Vlerës së Tarifës për Shërbimet Lidhur me Procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
- **Udhëzimi Administrativ Nr.07/2011** Për Licencim të Hartuesëve të Raporteve Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- **Udhëzimi Administrativ Nr.18/2015** Për Infromimin, Pjesëmarrje të Publikut Dhe Palëve të Interesuara në Procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
- **Udhëzimi Administrativ Nr.08/2012** Për Përcaktimin e Dokumenteve Për Aplikacion Për Pëlqim Mjedisor Sipas Llojit dhe Natyrës së Projekteve.

Projektet që i nënshtrohen VNM-së

- Në Shtojcën I. të Ligjit të VNM-së, janë të përcaktuara projektet që i nënshtrohen procedurës së VNM-së.
- Në Shtojcën II, të Ligjit të VNM-së, projektet e përcaktuara do të përzgjidhen duke u bazuar në shqyrtimin e tyre, rast për rast dhe sipas kritereve të përcaktuara në Shtojcën III.
- Projektet për të cilat, pas përzgjidhjes nuk kërkohet Raporti i VNM-së, aplikuesi duhet të i drejtohet Komunës së caktuar, ku realizohet projekti për nënshtrimin e procedurës për dhënien e **Lejes Mjedisore Komunale.**

Fazat e procedurës së VNM-së

Në procedurën e VNM-së përfshihen këto faza:

- **Përzgjedhja;**
- **Studimi**;
- **Shqyrtimi i Raportit të VNM-së.**

Përzgjedhja

Bazuar në informatat e prezantuara nga aplikuesi bashkë me kërkesën dhe bazuar në kriteret e përcaktuara në Shtojcën III

Ministria përcakton nëse projekti i propozuar mund të ketë efekte të theksuara në mjedis, dhe brenda 10 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, informon aplikuesin me shkrim lidhur me vendimin, nëse kërkohet Raporti i VNM-së ose jo.

Studimi

- Aplikuesi mund të kërkoj që Ministria ta njoftojë me shkrim lidhur me informatat mbi ndikimin mjedisor që duhet të përfshihen në Raportin e VNM-së - Njoftimin e Studimit.
- Aplikuesi ia paraqet këto informata Ministrisë, në një raport të shkurtër studimi, i cili nuk i kalon 3 faqe. Para se të japë mendimin e vet, Ministria do të konsultojë aplikuesin dhe autoritetet mjedisore.
- Ministria i shqyrton këto informata dhe harton Njoftimin e Studimit, i cili i përcillet aplikuesit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.
- Aplikuesi e harton Raportin e Studimit, i cili do të përfshijë informatat e përcaktuara nga njoftimi i studimit. Raporti i Studimit i bashkëngjitet Raportit të VNM-së, si shtojcë në Përmbledhjen Jo-Teknike.

Dorëzimi i kërkesë për P.M

- Raporti i VNM-së është dokument themelor i procesit të VNM-së.
- Raporti i VNM-së duhet të hartohet dhe të nënshkruhet nga personi fizik ose juridik i licencuar.
- Hartuesi i Raportit të VNM-së dhe aplikuesi, janë përgjegjës për saktësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave, të përfshira në Raportin e VNM-së.
- Aplikuesi duhet t`i dorëzoj Ministrisë 4 kopje të Raportit të VMN-së në formë të shkruar dhe 1 kopje në formë elektronike.
- Me dorëzimin e kërkesës me Raportin e VNM, aplikuesi dorëzon edhe dëshminë për pagesën e bërë.

Procesi i shqyrtimit te raportit të VNM

- Pas pranimit të kërkesës për P.M. në DMM, kontrollohet nga zyrtarët e VNM/VSM, nëse dokumentacioni nuk është kompletuar, atëherë njoftohet aplikuesi për plotësim dokumentacioni në afatin prej 30 ditësh.
- Nëse aplikuesi nuk përgjigjet, atëherë përfundohet procedura për shqyrtimin e raportit të VNM-së.
- Nëse dokumentacioni është i kompletuar, atëherë MMPH NJOFTON Aplikuesin për organizmin e mbajtës së Debatit publik.
- Debatit publik mbahet në afat prej 20 deri 30 ditësh pas infomimit të publikut të interesuar.

Faza përfundimtare e shyrtimit të Raportit të VNM

- Ministria/DMM e mban takimin e komisionit, shqyrton Raportin e VNM si dhe vërejtjet dhe mendimet nga debati publik dhe përgatit Propozim-Vendimin.
- Ministria/DMM, mund të kërkoj informata shtesë-afati 30 ditë.
- Propozim-Vendimi për Pëlqim Mjedisor, i përgatitur nga DMM dërgohet ne ZSP në afat prej 70 ditë nga dita e pranimit të Raportit të VNM-së.
- Në afat prej 10 ditësh, nga pranimi i Propozim-Vendimit për P.M, Ministria nxjerr vendim për dhënien/refuzimin e P.M për projektin dhe e njofton me shkrim Aplikuesin.
- Aplikuesi ka të drejtë të ankohet kundër vendimit në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Faleminderit për Vemendjen Tuaj!